



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Shkëlqim Beqiraj** më datë 30.07.2024 ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Konstatimi i shuarjes së masës së sigurimit ndalues *“Pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”*, të parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj të pandehurit Shkëlqim Beqiraj me vendimin nr.19, datë 08.03.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Atalanta Zeqiraj, Flora Hajredinaj dhe Erjon Çela bazuar në nenet 261, 262/2 dhe 267/2 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. 479, datë 31.07.2024, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin e shuarjes së masës ndaluese *“Pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”*, parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Shkëlqim Beqiraj** me vendimin nr.19, datë 08.03.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ekzekutuar më datë 09.03.2024 ora 12.30.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brënda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e marrjes dijeni lidhur me vendimin e arsyetuar.

Tiranë, më datë 31.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar